

Fjalë përshëndetëse

Reforma e nisur në sistemin e drejtësisë është padyshim reforma legjislative më e rëndësishme në Shqipëri që pas miratimit të Kushtetutës të vitit 1998. Marrja e statusit të vendit kandidat nga Bashkimi Europian në vitin 2014 përforcoi nevojën e kryerjes së një reforme të plotë dhe transformuese në sistemin e drejtësisë, reformë e cila do t'i japë rrugë zhvillimit të prioritetëve të tjera në procesin e integritit europian të vendit të tilla si lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, mbrojtja e të drejtave të njeriut, etj.

Suksesi i reformës në drejtësi do të varet nga vizioni strategjik i saj, procesi në të cilën kjo reformë do të realizohet, transparenca, profesionalizmi dhe gjithëpërfshirja. Ajo duhet të garantojë një konsultim të gjerë me institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë dhe një bashkëpunim konstruktiv me të gjithë grupet e interesit.

Ky moment i rëndësishëm reformues përkon me një nga prioritetet kryesore të dekadës së fundit të veprimtarisë së Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros, forcimin e shtetit të së drejtës dhe në veçanti me nismën e ndërmarrë vitin e fundit për rishikimin e Kushtetutës, si kusht për përmirësimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë. Mbështetja profesionale dhe financiare e reformës në drejtësi nga ana e Fondacionit motivohet jo vetëm nga dëshira për të dhënë një kontribut për transformimin e sistemit të drejtësisë në një sistem të pavarur, të drejtë, transparent dhe eficient në shërbim të qytetarëve, por njëkohësisht drejt vlerave të një shoqërie demokratike ku respektohet shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut, ku përgjegjësit e shkeljeve ndëshkohen nga një drejtësi funksionale. Këto vlera janë njëkohësisht ndër elementët kryesorë të misionit të Fondacionit Soros për një shoqëri të hapur.

Fondacioni Soros synon po ashtu që përmes ofrimit të mbështetjes profesionale dhe financiare për këtë proces me rëndësi kombëtare të kontribuojë në rritjen e

transparencës, gjithëpërfshirjes dhe informimit të publikut rreth kësaj reforme, për rritjen e besimit të opinionit publik ndaj sistemit të drejtësisë.

Ne besojmë se një proces reformues i suksesshëm i sistemit të drejtësisë do të jetë kyç për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian, e specifikisht për Kapitullin 23 dhe 24 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Është një nga sfidat më të mëdha të kohës për shoqërinë shqiptare, e cila do të kërkojë përkushtimin e plotë dhe luajal të gjithë klasës sonë politike dhe qytetarisë.

Andi DOBRUSHI

Drejtor Ekzekutiv

FONDACIONI SHOQERIA E HAPUR PER SHQIPËRINË, SOROS